



# TERMOFIX 2in1

Ngjyra	Paketimi	Konsumi si ngjitës	Konsumi si rrafshues
Bardhë, Gri	Thes 25 kg	3-5kg/m <sup>2</sup>	2-3kg/m <sup>2</sup>



## PËRSHKRIM

Ngjitës dhe rrafshues i perforcuar me fibra ,për pllaka izolimi termik, EPS, për fasadë dhe xokolaturë. Gëzon aftësi shumë të mira në punim dhe rezistencë të lartë,. Trashësia maksimale e shtresës per rrafshim deri ne 4 mm dhe per ngjitje deri ne 30 mm.

## FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen dhe rrafshimin e të gjitha tipeve të pllakave të izolimit termik, për veshje fasadash dhe xokolaturash. Për ngjitje panelesh mbi mure tulle (të kuqe), tulla termike, mure të përziara apo mure guri, betone, mbi suva të reja dhe të vjetra. Për realizimin e sistemeve të izolimit termik kapot, i përshtatshëm dhe për perforcimin e bazamenteve minerale për veshje të mëvonshme dekorative.

## PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhur, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Për bazamente që nuk janë të qëndrueshëm është e domosdoshme vendosja e kunjave fiksuese. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë, në kushte normale temperaturash (20° C).



**Per ngjitje:** Përziereni me një përzierës elektrik 6-7 litra ujë me 25 kg TERMOFIX në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 30 mm duke zene rreth 45% te pllakes me ngjites me metoden me topa dhe shirita . Përpara nivelimit të sipërfaqes me kollë vendosni kunjat fiksuese në varësi të pllakës së vendosur 5-6 kunjat/m<sup>2</sup>.

**Për rrafshim:** Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 4 mm. Ashtu në gjëndje të freskët aplikoni rretjen përforcuese në mënyrë që të zhytet në ngjitës. Në kënde apo në vëndet e bashkimit në dyer apo dritare është e nevojshme që të aplikohet dy herë rrjeta përforcuese. Temperaturat optimale të punimit janë nga 50°C deri në 350 °C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje rreth 5-7 ditë kjo varet nga kushtet atmosferike.



**TË DHËNAT TEKNIKE**

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	Bardhë, Gri
Kokrrizimi:	0.7 mm
Konsumi si ngjitës:	3-5 kg/m <sup>2</sup>
Konsumi si rrafshues:	2-3 kg/m <sup>2</sup>
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa vëllimore:	1.7 gr/cm <sup>3</sup>
Ujë për përzierjen:	6-6.5 litra ujë për 25 kg
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Ngjitja në beton (28 ditë):	0.7 N/mm <sup>2</sup>
Ngjitja në EPS (28 ditë):	110 kPa
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1